



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 803/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Xhevdet Abazi kryesues Nenad Lazić dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Tahir Ollurit kandidat për asamble komunale nga rradhet e subjektit politik Partia Demokratike e Kosoves (PDK) dega në Malisheve, paraqitur kundër komisionereve të vendvotimit 30471/101R në fshatin Marali dhe 3047A/01 për shkak të manipulimit dhe të mungesës së votave për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur më 11.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET si e palejueshme ankesa e Tahir Ollurit kandidat i PDK-se për asamble komunale në Malisheve.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 08.11.2013, nga Tahir Olluri kandidat i PDK-se për asamble komunale për komunën e Malisheves ku deklaroi se në qendren e votimit Marali-Malisheve nr.30471/101R nuk janë lajmëruar votat e Asamblese apo nuk janë hedhur në formular sipas vëzhgësve. Tahir Olluri nr5 i ka 78 vota, kërkoj që të kontrollohet qendra e votimit me nr 3047/1R. Në piken e votimit nr3047A/01R në Marali për kandidatin Tahir Olluri nga PDK-ja nuk janë publikuar fare votat. Kërkojmë që kjo të bëhet pasi ky kandidat ka 78 vota vetëm në këto pike votimi kurse nuk figuron fare ky rezultat.

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultatit preliminarë i shpallur nga KQZ-ja nuk është përfundimtar dhe mund të ndryshoj në çdo moment dhe po ashtu ankesa në fjalë për rezultat preliminar në vendvotim është dashtë të parashtrëhet në PZAP nga anëtarët e komisionit të vendvotimit sipas nenit 102.1 të LZP-së parashihet se “Çdo anëtarë i komisionit të Vendvotimit që ka vërejtje në rezultatet e shënuara në një vendvotim mund të regjistroj mospajtimin tij në librin e votimeve të vendvotimit dhe

mund të dërgoj një vërejtje te Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në përputhje me këtë ligj“. Në rastin konkret ankesa është parashtruar nga kandidati për anëtarë të kuvendit komunal që nuk është person i autorizuar sipas ligjit të parashtrori ankesë sipas dispozitës së lartcekur.

Bazuar në arsyet e sipërshënuar dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, mund të hidh poshtë (si të palejuar, të parregullta apo të pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat të cilat janë të pabazuara, apo të cilat janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

A nr. 803/2013 më datën 11.11.2013

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**



Këshillë juridike: *PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*